



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

Lënda: Shpallje e njoftimit të vendit vakant për Punëtor i Mirëmbajtjes

Drejtuar: Agjensisë së Prokurimit Publik

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e vëndit vakant në pozicionin Punëtor i Mirëmbajtjes . Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar, VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006 'Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike', Urdhërit Nr.624 datë, **05.12.2024 “Për Miratimin e Organikës së Klinikës Stomatologjike Universitare”**, si dhe për nevojat e institucionit kërkojmë njoftimin për vëndin e lirë të punës si më poshtë:

- Të ketë mbaruar Arsimin e Mesëm
- Të ketë përvojë pune në grup
- Te ketë eksperiencë pune në riparimin dhe mirëmbajtjen e godines.shërbime mirëmbajtjeje periodike

Detyrat e punetorit te mirembajtjes

- Eshtë në varësi të Përgjegjësit të Sektorit të Sherbimeve Mbështetese
- Punetori I mirmbajtjes ka per detyre të mirëmbajë godinën e Klinikës, kaldajën dhe sistemin e ujësjellësit brenda godinës.
- Të mirëmbajë aparaturat që lidhen me funksionimin normal të kaldajës.
- Të instalojë aparaturat e reja kur lind nevoja e ndryshimit të tyre.
- Të këshillojë stafin për mirëmbajtjen e godinës dhe aparaturave të kaldajës e zjarrfikësit.
- Të përgatisë listën e pjesëve të këmbimit dhe të materialeve për mirëmbajtjen e godines çdo vit brenda tremujorit të parë të vitit dhe ti dorëzoje prane Shefit te sektorit te sherbimeve mbeshtetese dhe burimeve njerezore si dhe te argumentoje materialet e dala nga magazina per punen e kryer tek Financa.
- Kujdeset per mirmbajtjen e ambientit brenda dhe jashte godines (gjelberimin , mirmbajtjen e lulishteve , higjenen e territorit etj).

Kandidatët e interesuar do të sjellin pranë protokollit të Klinikës Stomatologjike Universitare dokumentat si më poshtë :

1. Dëshmi Penaliteti.
2. Kërkesë me shkrim për aplikim për punë.
3. Jetershkrim sipas formatit standart
4. Fotokopje të noterizuar të listes së notave.
5. Fotokopje e letërnjoftimit (*ID*).
6. Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (*nga KML*).
7. Rekomandime, në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit
8. Deklaratë për vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Te gjitha dokumentet duhet te jene te noterizuara 6 mujorin e fundit.

Dokumentet mund të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të njësuar sipas ligjit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit të KSU, në adresën:

Rr. Dibra, QSUNT, Tiranë

Afati i dorëzimit: 7 ditë kalendarike nga data e njoftimit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Mënyra e njoftimit: Kandidatët do të njoftohen nëpërmjet emailit zyrtar të Klinikës Stomatologjike Universitare.

